



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR
TË GJIMNAZIT**

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: EKONOMI

KODI: 8. 4. 12. Z

**PROGRAMI I LËNDËS SË EKONOMISË
PËR KLASËN E 12^{të}**

TIRANË, PRILL 2010

Nëpërmjet këtij programi nxënësit identifikojnë dhe aftësohen në lidhje me njohuritë dhe shprehitë ekonomike bazë, që janë të nevojshme për të zhvilluar sipërmarrjen e biznesit si një nga kompetencat evropiane për arsimin.

Programi përshkohet nga katër linja, që janë: e drejta e biznesit, llogaritja e kostos dhe çmimit, objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit si dhe kontabiliteti, përmes të cilave synohet aftësimi praktik i nxënësit në lidhje me sipërmarrjen e biznesit.

Programi i lëndës “Ekonomi me zgjedhje”, është i lirë të përzgjidhet nga nxënësit që dëshirojnë të thellojnë njohuritë dhe shprehitë e marra në programin bërthamë të lëndës së “Ekonomisë”.

Përmes kësaj lënde nxënësit aftësohen të punojnë në grup, të ndërmarrin dhe realizojnë veprimtari në situata konkrete ekonomike, të bëjnë analiza dhe të arrijnë në përfundime konkrete.

Përmbushja e objektivave të kësaj lënde do të realizohet në klasën e 12-të në 68 orë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda synon të zhvillojë te nxënës/i-ja njohuri, aftësi dhe qëndrime në lidhje me organizimin, funksionimin dhe sipërmarrjen e një biznesi.

Nëpërmjet këtij programi thellohen dhe zgjerohen njohuritë e kurrikulës bërthamë të ekonomisë me një orientim të qartë nga tregu.

2 . OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në fund të realizimit të programit nxënës/i,-ja duhet:

- të përshkruajë karakteristikat, avantazhet dhe disavantazhet e formave kryesore të organizimit të biznesit dhe karakteristikat kryesore të një kontrate biznesi;
- të shpjegojë bazat e ligjit në rastet e paaftësisë për të paguar;
- të argumentojë objektivat më të rëndësishëm, detyrat dhe terminologjinë kyçe për kontabilitetin e kostos;
- të analizojë faktorët e përgjithshëm për vendimet në lidhje me sipërmarrjen (tregjet, klientët, konkurrencën, koston e shitjeve);
- të tregojë rëndësinë e marzhit të kontributit si një term qendror për kontabilitetin e kostos dhe ta llogaritë atë;
- të shpjegojë objektivat dhe strukturën bazë për kontabilitetin e kostos dhe kontabilitetin sipas qendrave të fitimit dhe të japë arsyet pse është i nevojshëm ndërjegjësimi për kostot dhe të menduarit si sipërmarrës;
- të analizojë objektivat më të rëndësishëm të një kompanie/biznesi dhe llogaritë treguesit që u korrespondojnë këtyre objektivave;
- të shpjegojë në parim pasqyrat financiare vjetore (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) të një kompanie/biznesi dhe të nxjerrë përfundimet e para prej tyre.

3. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE

34 javë x 2 orë = 68 orë

LINJA : E DREJTË BIZNESI

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i-ja zhvillon përmes kësaj linje njohuri, aftësi, qëndrime në lidhje me veçoritë e formave të ndryshme të biznesit, mënyrën e tyre të organizimit, veçoritë e kontratës së shitjeve si dhe rregullimet ligjore në rastet e paaftësisë për të paguar. Format juridike, kontratat e shitjeve, përfaqësimi, regjistri tregtar, grupe ndërmarrjesh, paaftësia për të paguar janë tematika të rëndësishme të kësaj linje.

Orë të sugjeruara ¹ : 18

Linja	Objektiva
E Drejtë biznesi	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te} nxënës/i,-ja;</p> <ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë arsyet e ekzistencës së formave të ndryshme ligjore të organizimit të biznesit;• të dallojë veçoritë dhe ndryshimet mes ortakërive dhe shoqërive të bashkuara;• të klasifikojë format individuale të organizimit të biznesit;• të interpretojë dhe duke përdorur shembuj nga realiteti: <i>kuptimet</i> “përgjegjësi personale e pakufizuar”, “përgjegjësi solidarë”, “përgjegjësi e kufizuar” dhe <i>termat</i> “vlerë nominale”, “vlerë e tregut të një aksioni”, “dividend”;• të dallojë veçoritë dhe tiparet e një shoqërie aksionare (SHA);• të analizojë tiparet karakteristike, avantazhet dhe disavantazhet e një “shoqërie të së drejtës civile”(ortakëri sipas Kodit Civil) dhe të “ortakut pasiv” (të heshtur);• të shpjegojë elementet e domosdoshme bazë të një kontrate shitjeje;

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor në këtë lëndë. Quhen të sugjeruara, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë, ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës

	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojë kriteret për një nënshkrim ligjërish detyrues; • të interpretojë rregullat bazë të përfaqësimit për format e ndryshme ligjore të organizimit të biznesit dhe si mund të kufizohet ose të zgjerohet autoriteti i përfaqësimit; • të interpretojë termat: “autoritet për të negociuar” (aktimi, autorizimi) dhe “prokurë” (aktimi, autorizimi); • të përshkruajë karakteristikat kryesore të një “regjistri tregtar”; • të shpjegojë karakteristikat në lidhje me organizimin e biznesit; • të interpretojë termat: “grup ndërmarrjesh” (kartel, trust, koncern), “grup ndërmarrjesh” (kartel, trust, koncern) dhe “paaftësi për të paguar” duke shpjeguar arsyet më të rëndësishme për paaftësinë për të paguar; • të interpretojë termat “zgjidhje jashtëgjyqësore” (gjykatë), “marrëveshje para falimentimit” dhe “falimentim” duke treguar dhe dallimet ndërmjet tyre.
--	---

LINJA : LLOGARITJA E KOSTOS DHE ÇMIMI

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i-ja në këtë linjë zhvillon njohuri, aftësi dhe qëndrime në lidhje me objektivat, detyrat dhe terminologjinë kyçe të kontabilitet të koston, për vendimet për sipërmarrjen, objektivat dhe strukturën bazë për kontabilitetin e koston duke u ndërgjegjësuar për koston dhe të menduarit si sipërmarrës. Qëllimet e llogaritjes së koston, konceptet e llogaritjes së koston, llogaritja e çmimit, kontabiliteti i qendrave të koston, kontabiliteti i qendrave të fitimit janë tema të rëndësishme të linjës.

Orë të sugjeruara: 16

Linja	Objektiva
Llogaritja e koston dhe çmimi	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te} nxënës/i,-ja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë objektivat për kontabilitetin e koston; • të bëjë dallimin ndërmjet kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të koston; • të shpjegojë arsyet e përshtatjes së të dhënave të marra nga kontabiliteti financiar përpara se të përdoren për kontabilitetin e koston; • të interpretojë dhe përmes dhënies së shembujve, termat: “elementet e koston”, “qendra të koston”, “njësi e koston” • të analizojë ndryshimin mes metodës së koston së plotë dhe metodës së koston direkte;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë faktorët që ndikojnë në mënyrë domethënëse në çmimin e një produkti; • të analizojë ndërveprimet ndërmjet kërkesës, ofertës dhe “çmim i tregut”; • të atribuojë marzhe të ndryshme çmimi ndaj formave përkatëse të tregut dhe të japë arsye për vendimet e tij/saj; • të shpjegojë: qëllimin e kontabilitetit sipas qendrave të kostos, qëllimin e fletës për shpërndarjen e kostove duke riprodhuar strukturën e saj bazë, qëllimin e shpërndarjes së kostove për shërbime të brendshme dhe të përbashkëta, qëllimin dhe strukturën bazë të kontabilitetit sipas qendrave të fitimit, pse një “marzh kontributi” pozitiv i një qendre fitimi nuk mund të barazohet me fitimin, masat bazë për të përmirësuar marzhin e kontributit të një qendre fitimi; • të llogarisë kostot për çdo zë kostoje dhe marzhin e kontributit të një qendre fitimi.
--	---

LINJA : OBJEKTIVAT E BIZNESIT DHE TREGUESIT E MENAXHIMIT

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i/ja në këtë linjë zhvillon njohuri, aftësi, qëndrime në lidhje me rëndësinë dhe zbërthimin e objektivave kryesore të një kompanie/biznesi, treguesit kryesorë të këtyre objektivave të biznesit si dhe për llogaritjen e këtyre treguesve. Përfitueshmëria, kthimi nga kapitali i vet (ROE), kthimi nga investimi (ROI), likuiditet, raporti i kapitalit të vet, fluksi i parave, produktiviteti janë çështje të rëndësishme në trajtimin e kësaj linje.

Orë të sugjeruara: 17

Linja	Objektiva
Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te} nxënës/i,-ja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojnë termat: “përfitueshmëri”, “kthim nga kapitali i vet”, “kthim nga investimi (ROI)”; • të llogaritë kthimin nga kapitali i vet dhe ROI; • të analizojë se një shoqëri është “fitimprurëse” nëse krijon fitim automatikisht; • të vlerësojë dhe duke i klasifikuar, çdo kthim të arritur nga kapitali i vet dhe çdo ROI të arritur ; • të interpretojë termat: “likuiditet” dhe “aktive likuide” duke i identifikuar ato saktë në pasqyrat financiare vjetore; • të shpjegojë termat: “raporti i kapitalit të vet”, “raporti

	<p>borxh –kapital”, “fluks i parave”;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të llogaritë: raportin e kapitalit të vet, raportin borxh – kapital dhe fluksin e parave (duke përdorur formulën bazë); • të analizojë termin “produktivitet” dhe arrijen e një produktiviteti të lartë si gjë shumë të rëndësishme për shoqërinë.
--	---

LINJA : KONTABILITETI

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i-ja në këtë linjë zhvillon njohuri në lidhje me njohjen dhe zbrëthimin e pasqyrave financiare vjetore të një biznesi që janë bilanci dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillon aftësi për të lexuar, interpretuar dhe nxjerrë përfundime bazuar në këto pasqyra financiare me qëllim marrjen e vendimeve mbi biznesin dhe ecurinë e tij. Objektivat e një pasqyre financiare vjetore, struktura e një bilanci, aktivitet, pasivitet, inventari, pasqyra e A& Sh, pasqyrat financiare vjetore, llogari të arkëtueshme/ llogari të pagueshme, provizionet, rezervat, amortizimi, analiza e një pasqyre financiare vjetore janë çështje të rëndësishme në këtë linjë.

Orë të sugjeruara: 17

Linja	Objektiva
Kontabiliteti	<p>Në përfundim të klasës së 12^{të} nxënës/i-ja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë objektivat kryesore dhe qëllimin e pasqyrave financiare vjetore (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve –A&Sh) duke treguar dhe rëndësinë e pasqyrave financiare; • të shpjegojë strukturën bazë të një bilanci; • të interpretojë dhe duke dhënë shembuj termat: “ana e aktiveve”, “aktive afatgjata dhe afatshkurtër”, “ana e pasiveve dhe e kapitalit”; • të shpjegojë qëllimin e përgatitjes së një inventari dhe hapat për përgatitjen e tij si dhe qëllimin dhe termat më të rëndësishëm të pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve (A&SH); • të tregojë pse pasqyrat financiare vjetore mund të përmbajnë transaksione, të cilat akoma nuk kanë shkaktuar një hyrje apo dalje aktiveve gjatë vitit të aktivitetit (periudhë kontabël); • të interpretojë dhe duke i identifikuar saktë në pasqyrat

	<p>financiare vjetore, termat: “llogari të arkëtueshme” “provizione”, “rezerva”;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë termat: “amortizim”, “shpenzime kapitale apo për t’u kapitalizuar”; • të nxjerrë përfundime bazë nga leximi i pasqyrave të thjeshta financiare (rast studimor).
--	--

4. KËRKESA TË EKONOMISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Ekonomia e avancuar	Matematika
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të llogarisë dhe përdorë përqindjen në raste të ndryshme. - Të jetë i aftë për të llogaritur mesataren. - Të bëjë përlllogaritjen e përpjesëtimeve. - Të interpretojë tabela, grafikë e diagrama statistikore.
Ekonomia e avancuar	Gjuha shqipe
Për të gjitha linjat	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënës/i-ja: - Të analizojë dhe interpretojë tekste të ndryshme. - Të shprehë opinione, të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe të debatojë në lidhje me probleme të ndryshme. - Të zhvillojë dialog, të dëgjojë me vëmendje. - Të bëjë prezantime duke përdorur teknika të ndryshme.
Ekonomia e avancuar	TIK
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përdorë pajisje <i>Input/Output-i</i>, CD, DVD, USB, disketa. - Të përdorë programe të ndryshme për punë të pavarura, për të krijuar tabela e paraqitje grafike dhe për të bërë prezantime të ndryshme (Word, Excel, Poëwer Point), etj. - Të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, Internetin, etj. për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. - Të përdorë Internetin dhe kërkimin në Internet për të gjetur materiale që do të shërbejnë për diskutime dhe analiza të ndryshme ekonomike.

Ekonomia e avancuar	Gjuhët e huaja (Anglisht dhe Frëngjisht)
Për të gjitha linjat	Nxënës/i-ja - Të zotërojë fjalorin e domosdoshëm për të kuptuar dhe përkthyer materiale të ndryshme. - Të shfrytëzojë fjalorin teminologjik në gjuhë të huaj si: biznes (business), sipërmarrje (enterprise), konsumator (consumer), treg (market), kërkesë (demand), ofertë (supply), konkurrencë (competition), bankë (bank), kosto (cost), çmim (price), fluks parash (cash floë), etj.
Ekonomia e avancuar	Gjeografia
Për të gjitha linjat	Nxënës/i-ja - të dijë dhe të përshkruajë koncepte bazë si: burime natyrore, burime njerëzore, eksport, import, etj. - Të shfrytëzojë mjete mësimore si hartat, globin, etj.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program zbatohet për 68 orë. Programi është një dokument zyrtar. Ai është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për kurrikulën e gjimnazit. Ai mbështetet dhe zërthen kornizën kurrikulare të gjimnazit që është dhe dokumenti kyç kurrikular për këtë nivel shkollimi. Zbatuesit e programit duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për të ndjekur kërkesat e Kornizës kurrikulare të gjimnazit sidomos në lidhje me këto zëra:

- Synimet e përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- Synimet e linjave ndër-kurrikulare;
- vlerësimin e nxënësit me notë;
parimet e mësimdhënie-mësimnxënies.

Përdoruesit e këtij programi duhet të njohin gjithashtu dhe programet e tjera lëndore që trajtojnë njohuritë ekonomike në gjimnaz.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, racore, fetare etj.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që t'i realizojnë ato. Realizimi i objektivave të linjave është i detyrueshëm për zbatuesit e programit. Kështu, për shembull, nëse programi i lëndës "Ekonomi me zgjedhje" kërkon që nxënës/i-ja të jetë i/e aftë të përcaktojë termin "ana e aktiveve" dhe të japë shembuj kjo do të thotë se, të gjithë nxënësve, duhet t'u jepet mundësia ta realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e këtij objektiv nxënësit duhet t'i jepet detyra, koha dhe mundësi të tjera që të mbledhë fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre.

Objektivat nuk duhet të mbeten abstrakt, të pa realizueshëm e të pa matshëm. Nëse një mësues/ese nuk e bën këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objekti nga nxënës/i,-ja si më poshtë:

- Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual).
- Aftësia për të shpjeguar dhe për të krahasuar (nivel mesatar intelektual).
- Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).

Programi realizohet edhe nëpërmjet zbatimit të kërkesave didaktike. Mësuesi duhet të njohë dhe të kërkojë zbatimin e kërkesave bazë, si:

- Nxënës/i-ja dallon kundërshtitë në pikëpamje.
- Nxënës/i-ja shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
- Nxënës/i-ja krijon qëndrimin e tij/saj për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve të ndryshme nga të vetat.

Së pari, mësues/i-ja duhet t'i krijojë çdo nxënës/i-eje mundësinë të shprehë arritjet e tij/saj në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësues/i-ja nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënës/i-eje që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij/asaj, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.

Së dyti, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë nxënës/in-en për nivelin e shprehur të arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij/asaj të gjitha mundësitë të shprehë aftësitë e veta.

Kujdes i veçantë duhet treguar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive intelektuale dhe sociale të nxënësve, si ato të debatit, diskutimit, punës në grup etj. Kështu mësuesi mund të japë si detyrë pyetje me nivel të ndryshme vështirësie, në përputhje me interesa të ndryshme të nxënësve, të cilat mund të bëhen si pikënisje për diskutim dhe debat në klasë dhe, shpesh herë, duke i sjellë si probleme të komunitetit ku jetojnë, për ta bërë debatin më praktik dhe më me interes.

Orët mësimore

Programi i lëndës “ekonomi me zgjedhje” për klasën e 12 të gjimnazit është strukturuar në katër linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësues/i-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit demonstronjë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës, “ekonomi me zgjedhje” afërsisht 60% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 40% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një linje të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- aftësimin nëpërmjet veprimtarive praktike për njohuritë bazë;
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen bazuar në linja;
- testimin pas çdo linje.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisjen nga ngjarje aktuale, ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: të maturit, të ndjekurit e udhëzimeve, të zbatimit të formulave të llogaritjes së treguesve të ndryshëm etj.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si aftësia e komunikimit, aftësia e menaxhimit të informacionit, aftësia e zgjidhjeve problemore, aftësia e të menduarit kritik dhe krijues.
- Aftësive që lidhen me veçoritë e lëndës.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si: qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i-ja zhvillon vetë e ndihmon nxënësit që, së bashku, të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si: me shkrim, me gojë, me projekte, simulimeve kompjuterike, etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup.. Nxënës/i-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i-ja parashton peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim, në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjëra orësh mësimore, që përbëhen nga linja, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësve, tek ato një orësh; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, raste studimore, etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni të prindërit të progresit të nxënësit, është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi/ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

Zbatuesit e programit duhet të kenë parasysh se vlerësimi i nxënësve vetëm me teste është i pjesshëm dhe nuk jep informacion të plotë mbi atë se çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi.